

Deklaratë për shtyp lëshuar nga Regjistruesi i Gjykatës

GJYKIM I DHOMËS
CARSON DHE TË TJERË kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR

Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut njoftoi sot me shkrim vendimin e Dhomës së saj¹ në rastin *Carson dhe të Tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar* (ankimi nr. 42184/05).

Gjykata u shpreh, me gjashtë vota kundrejt një vote, se **nuk ka pasur shkelje të Nenit 14** (ndalimi i diskriminimit) **në lidhje me Nenin 1 të Protokollit nr.1** (për mbrojtjen e pronës) të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. (Aktgjykimi është i disponueshëm vetëm në gjuhën angleze.)

1. Faktet Kryesore

Ankuesit janë 13 shtetas britanikë: Annette Carson, Bernard Jackson, Venice Stewart, Ethel Kendall, Kenneth Dean, Robert Buchanan, Terrance Doyle, John Gould, Geoff Dancer, Penelope Hill, Bernard Shrubsole, Lothar Markiewicz dhe Rosemary Godfrey, lindur ndërmjet viteve 1913 dhe 1937. Ankuesit e kishin kaluar shumicën e jetës së tyre të punës në Mbretërinë e Bashkuar, duke paguar kontributet e sigurimit kombëtar në mënyrë të plotë, para se të emigronin ose të ktheheshin në Afrikën e Jugut, Australi apo Kanada.

Rasti kishte të bënte me ankesën e ankuesve rreth refuzimit të autoriteteve të Mbretërisë së Bashkuar për rritjen e pensioneve të tyre në përputhje me ndryshimet në inflacion.

Në vitin 2002, zonja Carson ngriti procedura për mënyrën e shqyrtimit gjyqësor lidhur me pensionin e saj. Ajo pohoi se kishte qenë viktimë e diskriminimit duke u nisur nga fakti se pensionistët britanikë trajtoheshin në mënyra të ndryshme në varësi të vendit të tyre të banimit. Në mënyrë të veçantë, pavarësisht shpenzimit të së njëjtës kohe pune në Mbretërinë e Bashkuar, me shlyerje të kontributeve të njëjta për Fondin Kombëtar të Sigurimeve dhe me të njëjtën nevojë për një standard të arsyeshëm jetese gjatë pleqërisë së saj ashtu si pensionistët britanikë që jetonin në Shtetet e Bashkuara apo në vende të tjera, ku pension më i lartë disponohej nëpërmjet marrëveshjeve reciproke, pensioni bazë shtetëror i saj kishte qëndruar i pandryshuar në normën e pagueshme në datën e largimit të saj nga Mbretëria e Bashkuar.

Aplikimi i saj për shqyrtim gjyqësor u hodh poshtë në maj 2002 dhe ajo apeloi në Dhomën e Lordëve në maj 2005.

Sipas Nenit 43 të Konventës, brenda tre muajve nga data e Gjykimit të Dhomës cdo pale mund, në raste të jashtëzakonshme, të kërkojë që çështja ti referohet Dhomës së Madhe të përbërë nga 17 anëtarë të Gjykatës. Në këtë rast një panel prej pesë gjyqtarësh do të konsiderojë nëse çështja ngre një problem serioz i cili ndikon në interpretimin ose zbatimin e Konventës ose protokolleve të saj, ose një çështje serioze me rëndësi të përgjithshme, rast në të cilin, Dhoma e Madhe do të japë një gjykim përfundimtar. Nëse kërkesa për referim refuzohet, gjykimi i Dhomës do të jepet në formë të prerë pas skadimit të një afati tre-mujor ose më parë nëse palët deklarojnë se nuk synojnë të bëjnë kërkesë për referim.

Sipas gjykimit të Dhomës së Lordëve, vetëm njëri prej gjyqtarëve të cilët shqyrtuan ankesën e zonjës Carson u shpreh se ajo nuk ishte në një situatë analoge, ose të ngjashme, me situatën e një pensionisti të së njëjtës moshë dhe me të njëjtat kontribute, me banim në Mbretërinë e Bashkuar apo në një vend ku ishte bërë rritje vlerësimi pensionesh përmes një marrëveshjeje reciproke dypalëshe.

Përfitimet e sigurimeve shoqërore, përfshirë pensionin shtetëror, ishin pjesë e një sistemi të ndërlikuar dhe të mirëqenies sociale dhe tatimit që kishte ekzistuar për të siguruar standarde të caktuara minimale të jetesës për ata që jetonin në Mbretërinë e Bashkuar. Kontributet në Fondin Kombëtar të Sigurimit nuk mund të barazoheshin me kontributet për skemën e pensioneve private, sepse paratë përdorreshin, së bashku me paratë e siguruar nga tatimet e përgjithshme, për financimin e një sërë përfitimesh dhe ndihmash të ndryshme. Kushte mjaft të ndryshme ekonomike zbatoheshin në vende të tjera: për shembull, në Afrikën e Jugut, ku jetonte zonja Carson, edhe pse nuk kishte pothuajse fare sigurime shoqërore, kostoja e jetesës ishte shumë më e ulët, dhe vlera e randit kishte rënë në vitet e fundit në krahasim me stërlinën.

Gjykatat vendase theksuan më tej se zonja Carson dhe ata në pozitat e saj kishin zgjedhur të jetonin në shoqëri, apo ekonomi, jashtë Mbretërisë së Bashkuar, prandaj pranimi i argumenteve të saj do të çonte në ndërhyrje gjyqësore, në vendimin politik për ripozicionimin e fondeve publike.

Znj. Carson merrte një pension bazë shtetëror prej 67,50 £ (GBP) në javë. Kjo shumë kishte qenë e njëjtë që prej vitit 2000. Sikur pensioni bazë të ishte vlerësuar në përputhje me inflacionin, shuma tani do të kishte arritur vlerën prej 82.05 GBP në javë. Znj. Carson, tashmë në pension, varej tërësisht në pensionin e saj dhënë nga shteti britanik.

2. Procedura dhe përbërja e Gjykatës

Ankimi u paraqit në Gjykatën Europiane të të Drejtave të Njeriut më 24 nëntor 2005.

Organizatës jo qeveritare, *Age Concern*, iu dha leje të ndërhynte në procedura si palë e tretë më 24 janar 2008.

Gjykimi u dha nga një Dhomë prej shtatë anëtarësh, e përbërë si vijon:

Lech **Garlicki** (Polak), *Kryetar*,
Nicolas **Bratza** (Britanik),
Giovanni **Bonello** (shtetas i Maltës),
Ljiljana **Mijovi** (shtetas i Bosnjë dhe Herzegovinës),
David Thór **Björgvinsson** (shtetas i Islandës),
Ledi **Bianku** (Shqiptar),
Mihai **Poalelungi** (shtetas i Moldovisë), *gjyqtarë*,

dhe gjithashtu Fato **Aracı**, *Zv. Regjistruer i Seksionit*.

3. Përmbledhje e Aktgjykimit¹

¹ Kjo përmbledhje nga Regjistri nuk është detyruese për Gjykatën.

Ankesa

Ankuesit pretenduan, në veçanti, se refuzimi i autoriteteve të Mbretërisë së Bashkuar për rritjen e pensioneve të tyre në përputhje me inflacionin ishte diskriminues dhe se disa prej tyre duhet të zgjidhnin ndërmjet heqjes dorë nga një pjesë e madhe e të drejtës së tyre të pensioneve apo jetesës larg prej familjeve të tyre. Ata bazoheshin në Nenin 8 (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare), Nenin 14 (ndalimi i diskriminimit) dhe Nenin 1 të Protokollit Nr.1 (për mbrojtjen e pronës) të Konventës

Vendimi i Gjykatës

Neni 14 marrë në lidhje me Nenin 1 të Protokollit Nr. 1

Së pari, përsa i përket çështjes nëse ankuesit ishin në një situatë analoge me pensionistët britanikë që kishin zgjedhur të qëndronin në Mbretërinë e Bashkuar, Gjykata vuri në dukje se sistemi i sigurimeve shoqërore të Shtetit Kontraktues kishte për qëllim ofrimin e një standardi minimal të jetesës për banorët brenda territorit të saj. Përsa i përket funksionimit të sistemeve të pensionit apo të sigurimeve shoqërore, individët rezidentë të zakonshëm në Shtetin Kontraktues nuk ishin, pra, në një situatë analoge me ata që banonin jashtë territorit.

Për më tepër, Gjykata ishte në mëdyshje të gjetjes së një analogjie ndërmjet ankuesve të cilët jetonin në një vend ku "pensionet ishin të ngrira" (shuma e pensioneve nuk ndryshonte) dhe pensionistët britanikë, banorë të vendeve jashtë Britanisë së Madhe, ku përmes marrëveshjeve reciproke kryheshin rritje të pensioneve. Kontributet e Sigurimeve Kombëtare ishin vetëm një pjesë e sistemit të ndërlikuar të Mbretërisë së Bashkuar të taksimit dhe Fondi Kombëtar i Sigurimit ishte vetëm një nga një numër i burimeve të të ardhurave të përdorura për të paguar për sistemin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të Mbretërisë së Bashkuar. Pagesa e ankuesve e Kontributeve të Sigurimit Kombëtar gjatë jetës së tyre të punës në Mbretërinë e Bashkuar nuk ishte më e rëndësishme se sa fakti se ata mund të kishin paguar tatimin mbi të ardhurat ose taksat të tjera, ndërsa banonin atje. As nuk ishte e lehtë të krahasohe pozicionet përkatëse të banorëve të Shteteve të Bashkuara në afërsi gjeografike me kushte të ngjashme ekonomike, të tilla si Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Kanadaja, Afrika e Jugut dhe Mauricius, ose Xhamajka, Trinidad dhe Tobago, për shkak të dallimeve në dispozitat e sigurimeve shoqërore, tatimeve, normave të inflacionit, interesit dhe këmbimit valuator.

Siç theksohet nga gjykatat vendase britanike, modeli i marrëveshjeve reciproke ishte rezultat i historisë dhe perceptimeve në secilin vend të kostove të perceptuara dhe përfitimeve të një marrëveshjeje të tillë. Ata përfaqësonin atë që Shteti Kontraktues kishte qenë në gjendje të negocionte pa e vendosur veten në një disavantazh të panevojshëm ekonomik dhe për të aplikuar për të siguruar reciprocitetin e mbulimeve të sigurimeve shoqërore në të gjithë bordin, jo vetëm në lidhje me rritjen e pensionit. Sipas mendimit të Gjykatës, shteti nuk e kishte tejkaluar diskrecionin e tij të gjerë për të vendosur mbi çështjet e politikave makro-ekonomike duke lidhur marrëveshje të tilla reciproke me vendet e caktuara por jo shtetet e tjera.

Në çdo rast, Gjykata arriti në përfundimin se dallimi në trajtim ishte justifikuar në mënyrë objektive dhe të arsyeshme. Ndërsa ka pasur forcë në argumentin e ankuesve, theksuar nga *Age Concern (Shqetësimi për Moshën)*, që vendimi i një të moshuari për të lëvizur jashtë vendit mund të nxitet nga një numër faktorësh, duke përfshirë edhe dëshirën për të qenë afër

anëtarëve të familjes, vendbanimi ishte megjithatë një çështje zgjedhjeje. Prandaj, Gjykata ra dakord me qeverinë dhe gjykatat kombëtare që, në atë kontekst, i njëjti nivel i lartë mbrojtjeje kundrejt dallimeve në trajtim nuk nevojitej aq sa për dallimet e bazuara në gjini ose origjinën racore ose etnike. Për më tepër, shteti kishte marrë masa, në një seri broshurash të cilat i referoheshin Rregulloreve të Rritjes së Përfitimeve të Sigurimeve Shoqërore të vitit 2001, me qëllim informimin e banorëve të Mbretërisë së Bashkuar të cilët lëviznin jashtë vendit për mungesën e indeksit të lidhur për pensionet në vende të caktuara.

Më pas u vendos se nuk kishte pasur shkelje të Nenit 14 marrë në lidhje me Nenin 1 të Protokollit nr. 1.

Neni 14 marrë në lidhje me Nenin 8

Gjykata u shpreh unanimisht se nuk ishte i nevojshëm trajtimi veçmas i ankesës së ankuesit në bazë të Nenit 14 në lidhje me Nenin 8.

Gjyqtari Garlicki u shpreh me një vendim mospajtues, i cili i është aneksuar gjykimit.

Vendimet e Gjykatës mund të gjenden në faqen e saj të internetit (<http://www.echr.coe.int>).

Kontakte Shtypi

Adrien Raif-Meyer (telefon: 00 33 (0)3 88 41 33 37)

Tracey Turner-Tretz (telefon: 00 33 (0)3 88 41 35 30)

Sania Ivedi (telefon: 00 33 (0)3 90 21 59 45)

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut u krijua në Strasburg nga Shtetet Anëtare të Këshillit të Europës në vitin 1959 për trajtimin e shkeljeve të pretenduara të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut të vitit 1950.